



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 06-24782/23
Klinë, datë: 27.07.2023

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Grabanicë, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "AZEM BEJTA", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Këpuz dhe Rastoka. Tubimi u mbajt me datë 19 qershor 2023 dhe filloi në orën 16:00, ku morën pjesë: 19 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave, pas një përshëndetje për të gjithë të pranishmëve dhe falënderimit për pjesëmarrje, ka bërë një prezantim për shifrat që do të këtë buxheti për vitin 2024. Sipas tij buxheti për vitin 2024 do të jetë rreth 15 milion euro. Rreth 50% të buxhetit do të shkojnë për kategorinë paga dhe mëditje, ku janë parapare rreth 8 milion euro. Komuna e Klinës ka paraparë që ti shpenzoj 4.5 milion euro për investimet kapitale, për mallra dhe shërbime do të shpenzohen rreth 2 milion euro. Ndërsa për projektet e planifikuara infrastrukturore si dhe synimet i dha fjalën kryetarit Elezaj.

Kryetari Elezaj fillimisht falënderoi banorët e fshatrave Grabanicë, Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Këpuz e Rastoka për pjesëmarrjen e tyre në këto takime të rëndësishme dhe përfshirja e tyre në proceset e vendimmarrjes, siç është Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026. Ai theksoi që në këto zona po investohet në vazhdimësi e që ka të planifikuara edhe projekte të tjera si kanali i ujitjes Grabanicë-Dollovë në vlerë 68 mijë euro, ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në vlerë 55 mijë euro. Po ashtu edhe në Qeskovë janë ndarë 22 mijë euro

për rrugë dhe rregullim të infrastruktures nëntokësore. Mos të harrojmë edhe hapjen e bunarit në vlerë 5 mijë euro për shkollën.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Qazim Berisha – Fshati Grabanicë, pasi ju uroj mirëseardhje të pranishmëve, shprehi shqetësimin e tij lidhur me gjendjen e sistemit të rrjetit të rrymës nga KEDS. Lidhur me këtë problematikë ai kërkoi të shikohet mundësia për investime në shtylla elektrike, pasi në disa lagje është dëmtuar.

Gjevdet Berisha – Fshati Këpuz, Falënderon njëherësh kryetarin për investimet e bëra në fshatin Këpuz, ndërsa lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, shpalosi dy kërkesa; një rrugë fushore në drejtim nga Bistrica dhe ndriçim në disa rrugë të lagjeve.



Kastriot Arifi – Fshati Grabanicë, Gajtë debatit kërkoi rinovim në kanalin e ujitjes sepse është i dëmtuar dhe ka vështirësi në përdorim e gjithsesi është projekt shumë i nevojshëm.

Idriz Beqiri – Fshati Grabanicë, Falënderoi kryetari Elezaj për vizitën e në veçanti për punën dhe projektet që janë realizuar në fshatin Grabanicë, po që shpreson që investimet të mos ndalin dhe që çdo vit të ketë ndonjë investim të ri, pasi edhe si fshat ka një numër të madh të banorëve.

Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “AZEM BEJTA”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Këpuz dhe Rastoka, pjesëmarrës kanë qenë 19 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	1
Meshkuj	18
Total:	19

Takimi përfundoi në orën 16:42.

Procesmbajtësi:
Nikson Daka


Klinë, datë:

